



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. AKTI 3
11.07.2019

NR. VENDIMI 12
15.07.2020

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtar - Fran Prendi

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Olivia Myftiu**, sot më datë **15.07.2020**, perfundoj se gjykuari kërkesen penale qe i perket;

KËRKUES : Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Klodjan Braho**.

KUNDËR : SH.M, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Xxxx xxxx”, Pall.Xxxxxx, kat.4-të, Ap.5, me gjendje civile i martuar, me shtetësi shqipëtare.

Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Ardian Visha dhe av.Arben Prenga, anëtar të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

PËRSONA TË TRETË :

- 1.B.D, e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Tropojë dhe banuese në Tiranë. Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Arben Prenga, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.
- 2.Q.M, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur e banues në Fushë Krujë, , me shtetësi shqiptare. Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Arben Prenga, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.
- 3.B.D, i datëlindjes xx.xx.xxxx, me shtetësi shqiptare, me vendqendrim ne Dortmund, Gjermani. Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Arben Prenga, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.
- 4.E.D, e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Bajram Curri, me adresë banimi në Sydney, “xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx”, Australi. Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Adriatik Cama, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.
- 5.S.D, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Bajram Curri, me adresë banimi në Sydney, “xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx”, Australi. Mbrojtur dhe përfaqësuar nga av.Adriatik Cama, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI :

I. Konfiskimin e shumave monetare 174.810 Euro dhe 1.000 USD (*të depozitura për ruajtje në bankën Intesa San Paolo*), si dhe të shumës prej 9.605.000 lekë (*të depozituara për ruajtje në bankën Credins*), në zotërim të shtetasit SH.M.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive mësipërme të ngarkohet Z. Erjon Ricku, administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

BAZA LIGJORE:Ligji nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe krimeve të tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë*”(i ndryshuar) si dhe, Kodi i Procedurës Penale;

Gjykata ne perfundim te gjykimit te çështjes, si degjoj kerkesen e prokurorit per pranimin e kerkeses sipas objektit saje duke perjashtuar nga konfiskimi vlerën monetare prej 269 065(*dyqindë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e pesë*) lekë vendosur sekuestrimi me vendimin nr.17, datë 09.08.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duhet vendosur revokimi i masës së sekuestros dhe kthimin e saj shtetasit SH.M pasi është vlerë monetare e përfutur nga të ardhurat të ligjshme, degjoj palen e paditur dhe personat e trete qe u shprehen per rrezimin e kërkesës;

Pas shqyrtimit dhe vleresimit ne teresi te provave te nenshtruara ketij gjykimi;

V Ë R E N:

Se Prokuroria pranë kësaj Gjykate, me datë 07.08.2018, ka paraqitur kërkesën kundër shtetasit, SH.M, me objekt sekuestrimin e pasurisë, shumave monetare 174.810 Euro dhe 1.000 USD (*të depozitura për ruajtje në bankën Intesa San Paolo*), si dhe të shumës prej 9.605.000 lekë (*të depozituara për ruajtje në bankën Credins*), në zotërim të shtetasit SH.M. Pala kërkuese ka kerkuar për Administrimin dhe përdorimin e kesaj pasurie të ngarkohet Z. Erjon Ricku, administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë si dhe, për shkak se keto vlera monetare janë sekuestruar gjithashtu me cilësin e provës materiale në kuadër të procedimit penal në ngarkim të shtetasit SH.M, edhe pezullimin e pasojave të zbatimit të kësaj mase sekuestrimi deri në përfundimin e efekteve të masës së marra sipas Kodit të Procedurës Penale për të njëjtat shuma monetare.

Kjo kerkese eshte referuar si baze ligjore ne ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë*”.

Paraqitja e një kërkesë të tillë dhe fillimi i hetimit pasuror është paraprirë nga hetimi në kuadër të procedimit penal nr.27, viti 2017 i prokurorisë pranë kësaj gjykate. Nga aktet e ketij procedimi rezulton se shtetasi G.D pas një procesi penal është deklaruar fajtor për veprat penale të “*Vrasjes me paramendim*” dhe “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe në referim të këtyre dispozitave është dënuar me 20 (njëzet) vjet burgim. Ky shtetas është gjykuar në mungesë dhe vendimi gjyqësor i dhënë ndaj tij është ekzekutuar në vitin 2012, kohë kur është kryer edhe ekstradimi i tij nga SHBA në Shqipëri. Shtetasi G.D, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me një kërkesë me objekt rishikim vendimi.

Me vendimin Nr.00-2016-338, datë 24.02.2016 Gjykata e Lartë, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim vendimi të kërkuarit G.D. Prishjen e vendimit Nr.41, datë 26.01.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, vendimit Nr.38, datë 06.02.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit Nr.471, datë 26.07.2002 të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e akteve për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, me trup tjetër gjykues.

Në rigjykimin e kësaj çështje penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin Nr.94, datë 20.09.2016 ka vendosur ndryshimin e kualifikimit ligjor për të pandehurin G.D nga *"Vrasje me paramendim"* parashikuar nga neni 78 i K.Penal në *"Plagosje me pasojë vdekjen"*, parashikuar nga neni 88 i K.Penal, duke e dënuar përfundimisht atë me 8 (tetë) vjet burgim.

Ndaj vendimit Nr.94, datë 20.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është ushtruar e drejta e ankimit. Nga të dhënat e faqes elektronike të Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se në këtë gjykatë është regjistruar në datën 17.10.2016, çështja gjyqësore me të pandehur G.D, me relator gjyqtarin Agim Bendo. Nga të dhënat e administruara rezulton se anëtar i trupit gjykues në gjykimin e kësaj çështje gjyqësore ka qenë gjyqtari SH.M.

Duke patur informacione dhe dyshime rreth aktit korruptiv që ndodhte dhe pritej të ndodhte si për sa i përket korrupsionit pasiv dhe atij aktiv, nga Policia Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, është referuar ekzistenca e këtij fakti penal/veprimtarie kriminale në fushën e korrupsionit pasiv dhe aktiv me të dyshuar disa shtetas. Nga kjo e fundit, me datë 26.01.2017, është proceduar me regjistrimin e procedimit penal me nr.27/2017, për veprat penale *"Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë"* dhe *"Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë"*, të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të K.Penal. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale është shënuar si person nën hetim shtetasi G.D, si i dyshuar për veprën penale *"Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë"*, parashikuar nga neni 319 i K.Penal. Në vijim, pas hetimeve përkatëse, me urdhërin e datës 26.10.2017 në regjistrin e njoftimit të veprave penale të këtij procedimi është shënuar si person nën hetim edhe emri i shtetasit SH.M, etj.

Duke iu kthyer në menyre retrospektive fillimit të rrjedhjes së ngjarjeve që lidhen me faktin penal, theksojmë se në kuadër të zhvillimit të hetimeve në lidhje me këtë çështje mbi kërkesën e organit të akuzës me vendimet Nr. 99 datë 28.01.2017, Nr.168 datë 09.02.2017, Nr. 354 datë 21.03.2017, Nr.533 datë 28.04.2017, Nr.652 datë 25.05.2017, Nr.653 datë 25.05.2017, ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka disponuar për lejimin dhe zgjatjen e afateve të përgjimit për disa numra telefonikë. Gjithashtu nga ana e organit të akuzës është disponuar në datë 31.05.2017 me vendim për sekuestrimin e pajisjes aparat DVR (*Digital Video Recorder*) e markës *"HIKVISION"*, model DS-7208HVI-SH, SN:413099153 në lokalin *"ABC"* të ndodhur në Fushë-Krujë. Kjo pajisje më tej i është nënshtruar ekspertimit kompjuterik në lidhje me pamjet filmike të ruajtura në të për periudhën kohore 20.05.2017-25.05.2017.

Referuar të dhenave të përftuara nga përgjimet telefonike si dhe atyre që lidhen me operatorët telefonik celular rezulton se në muajin Maj të vitit 2017, shtetasi G.D i cili vuante dënimin në Fushë-Krujë, sipas hetimit paraprak ka realizuar kontakte telefonike me shtetasit N.Adhe A.B, duke udhëzuar ata të ofronin një shumë të hollash, me qëllim favorizimin e tij në gjykimin që do të zhvillohej në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në datë 23.05.2017, rreth orës 21:30, shtetasit N.A dhe A.B në lokalin *"ABC"* të ndodhur në Fushë-Krujë janë takuar me

shtetasin K.M. Në ambientet e lokalit shtetasi A.B i ka dhënë shtetasit K.M një zarf të bardhë i cili dyshohet të ketë patur një sasi vlerash monetare në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, dhe sipas hetimit dyshohet që kjo shumë do t'ju jepej gjyqtarëve të çështjes. Me vendimin Nr. 896 datë 07.06.2017 Gjykata e Apelit Tiranë, pas marrjes në shqyrtim të çështjes penale në ngarkim të shtetasit G.D ka vendosur *“Lënien në fuqi të vendimit penal Nr.94 datë 20.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”*.

Nga hetimi, konkretisht nga përmbajtja e komunikimeve telefonike nëpërmjet numrave telefonik celular të vënë në përgjim është konstatuar se shtetasi K.M nëpërmjet numrit të telefonit celular 0682088699 në përdorim të tij, ka pasur një sërë komunikimesh telefonike me numrin e telefonit celular 0692069688, i cili është i regjistruar në emër të shtetasit Shkëlqim Q.M, i cili ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe nga verifikimet e kryera rezulton të ketë qenë anëtar i trupit gjykues të çështjes penale në ngarkim të shtetasit G.D. Në datën 23.05.2017, shtetasi K.M, para dhe gjatë realizimit të takimit me shtetasit A.B dhe N.A, rezulton të ketë zhvilluar bisedë telefonike me shtetasin SH.M. Shtetasit K.M dhe SH.M kanë vijuar që të kenë komunikime telefonike në disa dite;24.05.2017;25.05.2017;26.05.2017;04.06.2017;05.06.2017;08.06.2017;09.06.2017;11.06.2017;12.06.2017 dhe 13-17.06.2017.

Mbi urdhrin e prokurorit, nga oficerët e policisë gjyqësore të Departamentit për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Tiranë është kryer analizimi i komunikimeve për disa numra telefonikë. Nga kompanitë telefonike është kërkuar informacion në lidhje me numrat telefonikë celularë, të regjistruar apo përdorur nga disa persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale. Janë marrë deklaramë në kuadër të hetimit nga disa shtetas të cilët janë pyetur si persona që kanë dijeni për veprën penale.

Duke vlerësuar se ekzistonte dyshimi se shtetasi G.D, në bashkëpunim me shtetasit A.B dhe K.M, kanë konsumuar veprën penale *"Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë"*, kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal, ndërsa shtetasi SH.M, i cili ushtron detyrën e Gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë dyshohet se ka konsumuar veprën penale *"Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë"*, të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, ndër të tjera, me datë 09.11.2017, me vendimin nr.282 Akti, datë 09.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është lejuar kontrolli personal, kontrolli i banesës dhe zyrës të shtetasit SH.M, për të kërkuar dhe sekuestruar shuma monetare që lidhen me veprën penale *"Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë"*, të parashikuara nga neni 319/ç i K.Penal.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit SH.M ka rezultuar se janë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 174,810(*njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dhjetë*) Euro, 1000(*një mijë*) USD dhe shuma prej 10,149,000(*dhjetë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë*) Lekë. Gjithashtu gjatë kontrollit të banesës në një dhomë tjetër është gjetur edhe vlera monetare prej 544 000 lekë e cila duke qenë se është vlerësuar se i përgjigjet nivelit të të ardhurave të ligjshme familjare i është kthyer të paditurit në përfundim të hetimeve paraprake me urdhrin e prokurorit të datës 20.04.2018.

Në të tilla rrethana është proceduar me datë 09.11.2017, në referim të nenit 253/1 të K.Pr.Penale ndalimi i menjëhershëm i shtetasit SH.M.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.417, datë 12.11.2017 është vendosur;

- *Vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të kryer ndaj personit nën hetim SH.M.*
- *Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj personit nën hetim SH.M, lindur më datë xx.xx.xxxx, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal.*

Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.146, datë 27.11.2017. Hetimi paraparak ka përfunduar dhe çështja është dërguar në gjykim pranë ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ku shtetasi SH.M ka marrur cilësin e të pandehurit për të njejtën vepër penale për të cilën ishte hetuar.

Me vendimin nr.17, datë 09.08.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me kërkesë të prokurorit është vendosur;

- 1) *Sekuestrimin e vlerave monetare në shumën 174,810(njëqindë e shtatëdhjet e katër mijë e teteqindë e dhjetë) Euro dhe 1,000(një mijë) Dollar USD, të depozitura për ruajtje në bankën Intesa San Paolo, Tiranë, në zotërim të shtetasit SH.M.*
- 2) *Sekuestrimin e vlerës monetare në shumën 9.605.000 lekë (nëntë milion e gjashtëqindë e pesë mijë) lekë, të depozitura për ruajtje në bankën Credins, Tiranë, në zotërim të shtetasit SH.M.*
- 3) *Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të mësipërme ngarkohet **Z.Erjon Ricku**, administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.*
- 4) *Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria Pranë Kësaj Gjykate si dhe Zyra e Përmbarimit Tiranë.*
- 5) ***Urdhërohet pezullimi i pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit**, sipas ligjit nr.10192, datë 03.12.2009(ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017) të vendosur me këte vendim, **deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal në kuadër të procedimit penal nr.27/2017 të Prokurorisë Pranë Kësaj Gjykate për revokimin apo shuarjen e masave që lidhen me keto pasuri(vlera monetare).***
- 6) *Urdhërohet sekretaria gjyqësore pranë kësaj gjykate të dërgojë menjëherë kopje të këtij vendimi në institucionet e mësipërme si dhe për njoftimin e zotëruesve të pasurive, shtetasit SH.M në adresën përkatëse.*

Ndërkohë që vazhdonte hetimi pasurorë për shtetasin SH.M, gjykimi i çështjes penale të themeli në ngarkim tij ka përfunduar, konkretisht me vendimin nr.129, datë 27.11.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, i pandehuri SH.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale, "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të parashikuara nga neni 319/ç të K.Penal duke u dënuar në kushtet e gjykimit të shkurtuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim si dhe një dënim tjetër plotësues. Gjithashtu gjykata ka vendosur ndër të tjera që shuma prej 30 000 euro esekuestruar në banesën e shtetasit SH.M të konfiskohet conform nenit 36/1 të KPrP, ndërsa vlerat e tjera monetare të sekuestruara po në banesën e këtij shtetasi, vlera 144 810 euro, 1000 dollar amerikan dhe 9 605 000 lekë të mbeten në ruajtje për llogari të procedimit pasuror të filluar. Me vendimin nr.18, datë 27.02.2019 të ish Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë ky vendim është lenë në fuqi me një

ndryshim për të të gjykuar SH.M vetëm si ai përket masës së denimit me burgim.

Sipas Ligjit nr.10192/2009, konkretisht neneve 5/2 dhe 22/1 të KPrP parashikohet respektivisht që, *Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj si dhe Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për atë që është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.*

Me ligjin nr.35/2017 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 7905, DATË 21.3.1995, *“KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”*, TË NDRYSHUAR, ka pësuar ndryshime nën 75/a i K.Pr.Penale si dhe, në frymën e ndryshimeve që sjellin dispozitat e këtij ligji ka pësuar ndryshim edhe nën 13 i K.Pr.Penale duke u zëvendësuar termi *“Gjykata për krime të rënda”* me *“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”*.

Gjithashtu referuar në nën 75/a të Kodit të Procedurës Penale, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.35/2017, vepra penale, *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, të parashikuara nga nën 319/ç të K.Penal gjykohej po nga Gjykata *“Për Krime të Rënda”*.

Megjithatë nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar funksionohet në bazë të kompetencës lëndore të ndryshme nga ajo e gjykatës së suprimuar, kjo veprë penale është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme të sapo krijuar dhe nuk përfshihet në kompetencën lëndore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Në të tilla rrethana gjykata, edhe pas këtyre ndryshimeve ligjore, në referencë me nën 13, 69, 75/a të K.Pr.Penale, konstatohet se gjykimi i kërkesës penale objekt shqyrtimi është në juridiksionin dhe kompetencën e saj.

Gjithashtu, krahas kompetencës në lëndë për gjykimin e kësaj kërkesë, gjykata referuar akteve përkatëse sa më sipër përshkruam, konstaton se shtetasi SH.M, është sërish subjekt i hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”*, konkretisht sipas nënit 3 të këtij ligji.

Ky person është me cilësinë e të dënuarit pasi në kuadër të procedimit penal nr.27/2017 të Prokurorisë për Krime të Rënda i është atribuar vepra penale, *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, të parashikuara nga nën 319/ç i K.Penal, për më tepër është gjendur fajtor dhe është dënuar po për këtë veprë penale gjatë gjykimit në themel dhe ky vendim ka mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat ligjore sipas nënit 3/1, pikë *“d”*, të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”* (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017).

Duke u gjendur i plotësuar fakti se ky shtetas është subjekt i hetimit pasurore, gjykata gjate shqyrtimit te kërkeses objekt gjykimi procedoj me zhvillimin e gjykimit duke iu referuar edhe kërkesave ligjore të nenit 22 të Ligjit nr.10192/2009 duke thërritur me kërkesë të palëve, me cilësin e përsônit të tretë, shtetasit B.D e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Tropojë dhe banuese në Tiranë; Q.M, i datëlindjes xx.xx.xxxx, me shtetësi shqiptare; B.D, i datëlindjes xx.xx.xxxx, me shtetësi shqiptare, me vendqendrim ne “xxxxxx”, kodi postar 44263, Dortmund, Gjermani; E.D, e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Bajram Curri, me adresë banimi në Sydney, “xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx”, Australi dhe S.D, i biri i Idriz, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Bajram Curri, me adresë banimi në Sydney, “xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx”, Australi .

Këta shtetas janë të aferm të familjes të të paditurit, konkretisht; shtetasi Q.M është babai i shtetasit SH.M, shtetasja B.D e B.D janë përkatësisht bashkëshortja dhe kunati i të paditurit, ndërsa shtetasit Elfa e S.Dtë aferm të bashkëshortes të të paditurit.

Legjitimimi i tyre me cilësin e përsônit të tretë u bë pasi ata kishin pretendime se vlerat monetare të sekuestruara dhe për të cilat kërkohej edhe konfiskimi u përkisnin atyre dhe ishin fituar në rrugë të ligjshme. Gjykata duke qenë se disa prej tyre kishin vendbanim jashtë vendit procedoj me njoftimin e tyre sipas kërkesave ligjore përkatëse si dhe u dha gjithë kohën e nevojshme atyre dhe përfaqësuesve të zgjedhur, mbrojtësve respektiv, me qëllim që si aktet e përfaqësimit ashtu edhe provat e pretenduara të merreshin në formën dhe mënyrën e kërkuar nga ligji.

Kështu, sa i përket dy përsônave të trete E e S.D të cilët kishin vendqëndrim shtetin Australian gjykata u kujdes që dokumentacioni përkatës i paraqitur prej tyre të kishin vulën apostile, lëshuar nga organi kompetent(*Sekretari i Departamentit të Punëve të jashtme dhe Tregtisë të Komunuelthit të Australisë, etj.*) sipas Konventës së Hagës(5 tetor 1961) e cila ka të bejë me legalizimin dhe apostilimin e dokumentave.

Duke iu rikthyer themelit të çështjes gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit SH.M ka rezultuar se pasi janë gjetur një sasi prej 174,810(*njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dhjetë*) Euro, 1000(*një mijë*) USD dhe shuma prej 10,149,000(*dhjetë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë*) Lekë, ato janë sekuestruar në kuadër të procedimit penal nr.27/2017 dhe janë lënë në ruajtje në bankat respective, vlera monetare prej 174.810 Euro dhe 1.000 USD janë depozituar për ruajtje në bankën Intesa San Paolo si dhe shuma prej 9.605.000 lekë janë depozituar për ruajtje në bankën Credins(*nga vlera monetare në lekë i janë kthyer përsônave nën hetim pasuror vlera 544.000 lekë, pasi ka rezultuar me prejardhje të ligjshme.*). Vlera monetare tjeter që është gjetur gjatë kontrollit të banesës në një dhomë tjetër në shumën 544 000 lekë duke qenë se është vlerësuar se i përgjigjej nivelit të të ardhurave të ligjshme familjare i është kthyer të paditurit në përfundim të hetimeve paraprake me urdhërin e prokurorit të datës 20.04.2018.

Ne kuader te veprimeve perkatese për shtetasin SH.M dhe familjaret e tij janë kryer verifikimet e duhura hetimore paraprake dhe ndaj këtyre të fundit janë identifikuar pasuritë të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se lidhen dhe rrjedhin nga veprimtaria kriminale e ushtruar nga ky shtetas. Kështu është administruar nga organi proçedues kopje e deklaratës së pasurisë të kryer nga shtetasi SH.M në zbatim të ligjit nr.84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, të depozituar në datën 25.01.2017. Nga përmbajtja e kësaj deklarate ka rezultuar se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës shtetasi i mësipërm ka deklaruar se zotëron një llogari kredie bankare, me gjëndje në shumën 22.643 euro, si dhe një llogari në shumën prej 63.077 lekë. Në deklaratën e pasurisë të dorëzuar në datën 25.01.2017 shtetasi SH.M dhe familjarët e tij nuk ka deklaruar në pronësi, në posedim apo në përdorim shuma të tjera monetare.

Gjatë fazës së hetimeve penale janë kryer një sërë veprimesh dhe verifikimesh të tjera pasurore me qëllim për të verifikuar edhe të ardhurat e fituara në mënyrë të ligjshme nga shtetasi SH.M dhe bashkëshortja e tij B.D (M). Duke marrë në konsideratë të ardhurat e fituara në mënyrë të ligjshme për periudhën nga data 25.01.2017 deri më datë 09.11.2017, që kanë qënë vetëm të ardhurat e fituara nga paga e shtetasve të mësipërm, është arritur në përfundimin se nga shumat monetare të sekuestruara, shuma prej 544.000 lekë, ka qënë të fituara në mënyrë të ligjshme. Për pasojë, me urdhërin e Prokurorit datë 20.04.2018, është vendosur kthimi i shumës prej 544.000 lekë shtetasve SH.M dhe B.D.

Vlerat monetare në shumat e tjera përkatëse, të mësipërme, janë shuma që nuk iu përgjigjen të ardhurave të deklaruar më parë prej tij dhe të përfituara në mënyrë të ligjshme në periudhën janar-nëntor 2017. Duke u nisur nga rezultatet e veprimeve hetimore të deritanishme të hetimit penal si dhe duke vlerësuar rezultatet e verifikimeve pasurore të kryera në lidhje me shtetasin SH.M, rezulton se, edhe gjatë këtij gjykimi sikundër ka konkluduar prokurori, ndodhemi në rastin kur plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret për marrjen e masave palandaluese pasurore për pasuritë në zotërim të shtetasit SH.M, si pasuri të cilat nuk kan rrjedhur nga veprimtari ekonomike te ligjshme.

Gjatë fazës së hetimit pasuror nga prokurori është proceduar me kryerjen e një ekspertimi kontabël.

Duke qene se gjate shqyrtimit gjyqësor nga palët kishte pretendime ne lidhje me perllogaritetet e te ardhurave si dhe te shpenzimeve te te paditurit dhe përsoneve të trete, prej tyre u kërkuar te caktohet nje ekspert kontabel per te sqaruar faktet e rrethanat qe lidhen me çeshjen objekt gjykimi.

Gjykata pasi vleresoj kete kerkese ne raport me kompleksitetit e çeshtjes vleresoj se per konstatimin e sqarimin e fakteve kerkohen njohuri te posaçme ne fushen e finance kontabilitetit, pasi kemi te bejem me pasqyrimin financiare, pasqyra te llogarive bakare, te

ardhura pagash, etj., per pasoje duke çmuar se jane kerkimet e nenit 22/1 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe krimeve të tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*(i ndryshuar) si dhe, ne nenet 178, 179, 182, 366 të Kodit të Procedurës Penale vendosi caktimin e një eksperti kontabel te autorizuar.

Eksperti pasi u njoh me materialet e çështjes objekt gjykimi si dhe evidenca, llogari e dokumenta te tjera te cilat i çmoj te nevojshme dhe qe lidhen me çështjen iu kërkua që ti jepte pergjigje pyetjeve qe lidhen me perllogaritje dhe analize kontabel te dokumentacionit perkates ne menyre qe te arrihet ne nje perfundim te sakte per nivelin e te ardhurave qe ka disponuar secili nga te paditurit, shpenzimet e kryera duke perfshire ketu edhe minimumin jetik per familjen e tij si dhe, diferencen mes tyre per periudhen kohore nga data 25.01.2017 deri më datë 09.11.2017 që përkon me deklarimin e të paditurit tek deklarata e pasurisë(*i padituri ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë pasi ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë*) dhe me kohën kur janë sekuestruar vlerat monetare gjatë kontrollit policor. Konkretisht ekspertit iu kërkua që pasi të njihet me materialet e çështjes objekt gjykimi si dhe evidenca, llogari e dokumenta të tjera të cilat i çmon të nevojshme dhe që lidhen me çështjen duhet ti japi përgjigje pyetjeve; *Çfar gjendje financiare ka patur shtetasi SH.M dhe pjestarët e familjes së tij, me datë 25.01.2017 ? Cilat jane të ardhurat financiare që ka realizuar ky shtetas dhe pjestarët e familjes së tij, gjatë periudhës kohore nga data 25.01.2017 deri më datë 09.11.2017 ? Në çfar vlere janë shpenzimet familjare të ketij shtetasi duke iu referuar minimumit jetik te te ardhurave për periudhen e mesiperme si dhe shpenzime te tjera nese jane bere nga personi apo familjare te tije mbi vleren e minimumit jetik(duke perfshire shit-blerje pronash, shpenzime per ndertime te ndryshme, etj.)?Duke ju referuar pergjigjeve te pyetjeve sa me siper te percaktohet raporti mes të ardhurave dhe shpenzimeve duke konkluduar se cila është vlere monetare e kursyer nga sejcili prej tyre dhe në total deri me datë 09.11.2017, nëse janë kursyer vlere monetare?Të percaktohet natyra e dokumentacionit të paraqitur nga përsonat e tretë në kuptim të të dhënave bankare që lidhen me pagesat e ndryshme, transferim fondesh, natyra e transaksionit, qëllimi, përfituesi i transfertes, etj. dhe të percaktohet nëse ndikon në përgjigjen e pyetjeve sa më sipër dhe nëse po të përpilohet një pergjigje alternative.*

Gjykata duke iu referuar gjitha akteve e provave të nënshtruara ketij gjykimi duke përfshire edhe pretendimet e palëve si dhe vleresimit te eksperteve kontabel arrin ne konkluzionin se së pari,ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrje të personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji; së dyti rezulton se pasuria është, drejtpërdrejt në zotërim të plotë të të paditurit SH.M dhe bashkëshortes së tij të cilët janë persona të përmendur në nenin 3, pika 1, të ligjit nr.10192/2009 dhe së treti nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme dhe personat e përmendur në nenin 3, të këtij ligji, nuk arrijnë të përlligjin zotërimin e të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruarat prej tyre.

Gjendja financiare, vlerat monetare që i padituri SH.M dhe familja e tij kanë patur në banesë me datë 25.01.2017 janë 73 583 lekë dhe 22 643 euro duke konstatuar edhe kredin në gjendje të pashlyer në vlerën 32026 euro. I padituri SH.M duke qenë se në atë kohë ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka plotësuar edhe dokumentacionin/formularin përkatës për deklarimin e pasurisë sipas procedurës përkatëse për rivlersimin kalimtar të gjyqtarve dhe prokurorve. Gjendja financiare sa më sipër është deklaruar nga subjekti në formularin përkatës të deklarimit të pasurisë.

Përsoneit nën hetim pasuror SH.M i është kontrolluar banesa dhe zyra si dhe i është nënshtruar kontrollit fizik nga policia gjyqësore me datë 09.11.2017. Sipas procesverbaleve të kontrollit të banesës datë 09.11.2017 dhe procesverbalit të sekuestrimit të sendeve datë 09.11.2017 provohet se në banesën e tij janë gjetur dhe më pas sekuestruar një sasi vlerash monetare, konkretisht; 174,810(*njëqindë e shtatëdhjetë e katër mijë e teteqindë e dhjetë*) Euro, 1,000(*një mijë*) Dollar USD si dhe 9.605.000 lekë (*nëntë milion e gjashtëqindë e pesë mijë*) lekë. Gjithashtu gjatë kontrollit të banesës në një dhomë tjetër është gjetur edhe vlera monetare prej 544 000 lekë e cila duke qenë se është vlerësuar se i përgjigjet nivelit të të ardhurave të ligjshme familjare i është kthyer të paditurit në përfundim të hetimeve paraprake me urdhërin e prokurorit të datës 20.04.2018.

Nga ana tjetër, sipas Deklaratës së pasurisë së shtetasit/subjektit deklarues (gjyqtar) SH.M, datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, të depozituar në datën 25.01.2017, rezulton nga përmbajtja e sajë se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës, ky subjekt ka deklaruar zotërimin në një llogari bankare të shumës 22.643 euro dhe një llogari në shumën prej 63.077 lekësh.

Duke patur në konsiderat se nga data 25.01.2017 e deri me date 09.11.2017 të ardhurat e familjes së këtij shtetasi(neto), si pasojë e të ardhurave të tij dhe bashkëshortes nga puna e kryer(paga) si dhe nga shitja e një pasurie të paluajtshme, janë në vlerën 7 384 026 lekë përkundrejt shpenzimeve në masën 6 570 961 lekë, konstatohet dhe rezulton se diferenca e tyre është në vlerën monetare 813065 lekë. Duke zbritur sërish vlerën e kthyer prej 544000 lekë rezulton se vlera monetare që i padituri ka patur në banesë në momentin e kontrollit dhe që i përgjigjet nivelit të të ardhurave të ligjshme familjare dhe që nuk është kthyer por i është nënshtruar sekuestrimit, është 269 065 lekë (813065-544000). Duke zbritur këto vlerë monetare prej 269065 lekë nga vlera e sekuestruar 9605000 lekë e cila nuk i përgjigjet plotësisht të ardhurave të ligjshme rezulton diferenca 9 335 935 lekë e cila duhet të konfiskohet.

Duke krahasuar të dy aktet e ekspertimit kontabel të realizuara si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjykimit në raport dhe reference me gjitha aktet e provat e tjera duke përfshirë edhe ato të paraqitura nga palët gjatë gjykimit të çështjes arrihet në konkluzionin se ekspertimi i kryer gjatë fazës së hetimit pasuror është më i saktë dhe i plotë përkundrejt ekspertimit kontabel të kryer gjatë gjykimit.

Nisur nga fakti se gjatë gjykimit u paraqitën nga palët, i padituri dhe përsoneat e tretë, disa prova dokument duke pretenduar se provonin prejardhjen e ligjshme të vlerave monetare të

sekuestruara, gjykata edhe me qëllim që të mosparagjykojë dhe për më tepër mos krijoj bindjen tek palët në paragjykimin e çështjes, vlerësoj se para ekspertit kontabël të shtroheshin për zgjidhje edhe pyetje alternative. Konkretisht të natyrës që përgjigjia të bazohet në marrjen në konsiderat të të ardhurave të pretenduara dhe ndikimin e tyre në konkluzionin e ekspertimit ashtu edhe mosllogaritja e tyre duke përcaktuar serish ndikimin tek konkluzioni përkatës kontabël.

Kështu në aktin kontabël gjatë gjykimit eksperti ka bere përllogaritje të gabuara si duke marre ne konsiderat te ardhura që u përkasin personave të tjere te cilet nuk kanë asnje lidhje me palet në gjykim(lapsus ne emrat përkatës), ka llogaritur si te ardhura te ligjshme disa vlera monetare te pretenduara se u përkinsin personave të trete të cilet i kishin lene në shtepin e te paditurit kohe me pare, etj. gjë e cila nuk u provua gjatë gjykimit e për pasoje nuk mund te merret në vleresim të gjykatës si i drejte as konkludimi i ekspertit i cili bazohet tek keto vlera monetare te pretenduara, etj. Nga eksperti gabimisht i referohet ne analizen perkatese koncepteve të tilla si, te dhenave probabel, te mundshme per te ndodhur ose qe mundet te kene ndodhur, gje e cila del jashte analizes së kontabilitetit. Pra nuk mund te behet pjese e llogaritjeve kontabel dhe të përfshihet ne konkluzionin e ekspertit nje vlere monetare qe i referohet nje veprimtarie ekonomike e cila ekziston vetem si nje probabilitet i mundshem per te ndodhur, pra nje e dhene e nje karakteri empirik.

Eksperti gjate gjykimit gjithashtu ka llogaritur gabim te ardhurat nga paga e personit te trete B.D, per periudhën 25.01.2017 deri me date 09.11.2017, nga 734787 lekë në 585842 lekë. Po kështu ka llogaritur konsumin mujor nga 315514 lekë në 506113 lekë si dhe nuk ka llogaritur nga te ardhurat terheqje nga banka në vlerën monetare 63000 lekë. një pjesë të ketyre gabimeve dhe lapsuse eksperti i plotesoj pasi iu dha nje kohe shtese.

Personi i Trete Q.M ka pretenduar se ne banesen e te paditurit kishte lene per arsye sigurie vleren monetare prej 9000000 leke. Si ky pretendim ashtu edhe burimi i ligjshem i kesaj vlere monetare nuk u arrit që të provohej gjatë gjykimit. Te ardhurat e pretenduara iu referuan te dhenave te terthorta sipas te cilave personi kishte kryer nje veprimtari ekonomike private(kishte privatizuar nje automjet transporti dhe qe perseri me probabilitet te rastit nga kjo veprimtari ishin perfituar keto te ardhura. Po keshtu nuk është i besueshem as fakti se vlera monetare ishte lene ne banesen e te paditurit per arsye sigurie. Personi i Trete Q.M duke iu referuar shkreses se Bankes(BKT), vertetimit nr.22 prot., datë 05.02.2020 rezulton se ka disponuar ne vitin 2011 shumen 1 500 000 lekë të cilen e ka depozituar ne nje llogari kursimi me qellim perfitimin e interesave perkatese. Kjo depozite kursimi ka qene aktive deri me date 23.01.2019. Edhe vajza e tij A.M ka qene ne veshteresi financiare dhe per pasoje ne pamundesit te kurseje vlera te tilla monetare. Prej saj jane perfituar dy here kredi bankare njera prej te cilave ka qene ende e pa shlyer ne kohen e sekuestrimit te vlerave monetare te te paditurit.

Edhe argumentet e mbrojtjes se shtetasi B.D ka lene ne banesen e te te paditurit vleren 50000 euro nga viti 2005 deri ne vitin 2015, eshte i pa mbeshtetur ne asnje prove. Po keshtu eshte i pa bazuar edhe pretendimi se personat e trete E e S.D me vendqendrim

jashte vendit(Australi), nepermjet perfaqesuesit tyre kane pretenduar se kane shprehur interes per investimin ne blerjen e disa pasurive te pa luajtshme dhe per kete qellim kane lene ne banesen e te paditurit vleren 120 000 euro gjate periudhes 2012-2017.

Per secilen nga vlerat e pretenduara nuk u provua ndonje rrethane konkrete fakti qe sjell njohje mbi burimin real te te ardhurave ne shtetin perkates po ashtu edhe ne lidhje me lenjen e vleres monetare ne banesen e te paditurit. Per asnjeren nga rastet e pretenduara nuk u soll asnje dokument i cili te provonte ndonje transaksion financiar bankar mes personave te trete dhe shtetasit SH.M. Per me teper nje pretendim i tille bie ndesh haptazi edhe me provat dokument, te dhenat e perftuara nga sistemi TIMS, i cili dokumenton hyrje daljet e ketyre shtetasve ne territorin e vendit tone. Te dhenat tregojne levizje te rralla te ketyre personave ne raport me pretendimin e tyre per periudhat e pretenduara duke pare kete fakt edhe ne raport me mungesen e deklarimit prej tyre te ndonje shume monetare gjate kalimit ne pikat kufitare. Nje fakt i tille rezulton nga shkresa nr.9875/1 prot., date 20.04.2018 e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Tiranë.

Gjithashtu, asnje rrethane, vlere monetare, etj. marredhenie financiare mes shtetasit SH.M dhe personave te trete nuk eshte e dokumentuar ne asnje prej deklarave te pasurise qe ai ka dorzuar ne institucionin perkates shteteror.

Nga te dhenat e perftuara nga Bankat e nivelit te dyte nuk rezulton asnje e dhene e cila dokumenton nje rrethane fakti qe lidh ndonje transaksion financiar bankar, transfert, etj. mes te paditurit dhe ndonje nga personat e trete.

Ne te kundert me sa pretendon mbrojtja sipas ligjit nr.10192/2009 barra e proves u takon subjekteve te ligjit, personave te permendur ne piken 3. Ne nenin 21/3 te Ligjit eshte parashikuar ne menyre eksplicite se, Personat e permendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji, kanë barrën për të provuar se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara, të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar nga burime të ligjshme. Per asnjeren nga vlerat monetare sa me siper nuk u arrit te provohej se ato jane fituar nga burime te ligjshme.

Provat e pretenduara nga mbrojtja apo rrethana fakti si, privatizimi i nje zisi(mjet transporti privatizuar ne vitin 1992 nga Q.M), te ardhura nga pensioni apo veprimtaria bujqesore, etj.(po per shtetasin Q.M), sjelljen ne forme cash te vlerave monetare me qellim investimin ne ndonje pasuri te paluajtshme ne te ardhmen ose lenjen e tyre ne ruajtje per arsye sigurie tek banesa e te paditurit, etj. jane pretendime qe qendrojne larg barres se proves ne kuptim te nenit 3, pika 1, të këtij ligji.

Ne nenin 24 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe krimeve të tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*(i ndryshuar), eshte parashikuar se;

1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;

b) rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të

plotë personit. kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personave të permendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji.

c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat e permendur në nenin 3 të këtij ligji, nuk arrijnë të perligjin zoterimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shperpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

2. Në rastin kur personi nuk mund të perligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve.

3.-----

Në rastin object gjykimi, rezulton se vlerat monetare të sekuestruara në banesën e të paditurit SH.M (me përjashtim të vlerës 269065 lekë) janë vlera monetare që i përkasin atij, nderkohe që ai është subject i Ligjit nr.10192/2009, parashikuar në nenin 3, pika 1, të këtij ligji. Për asnjërin prej tyre nuk provohet se ka prejardhje të ligjshme pasi asnjëri nga të paditurit dhe personat e trete nuk arrijnë të perligjin zoterimin e të ardhurave, të cilat janë shperpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre. Duke gjendur të plotësuar kërkesat e kësaj dispozite ligjore dhe në tërësi referuar Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe krimeve të tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”* (i ndryshuar), gjykata çmon se për keto pasuri duhet vendosur konfiskimi dhe për pasojë kërkesa e prokurorit duhet të pranohet.

Nga ana e gjykates me vendimin nr.17, datë 09.08.2018 ndër të tjera është vendosur sekuestroja e vlerës prej 30000 euro, pjesë e vlerës prej 174810 euro të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës.

Është për tu theksuar fakti se prokurori në diskutimin perfundimtar u shpreh se nuk hiqte dorë nga konfiskimi i vlerës prej 30000 euro, për të cilën me kërkesë të tij gjykata ka vendosur edhe sekuestron, por duke qenë se ajo vlerë është konfiskuar me vendimin penal nr.129, datë 27.11.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, është e pa nevojshme për tu shprehur për konfiskimin e saj. Një pretendim i tillë në vlerësim të kësaj gjykate vlerësohet i pa bazuar. Ligjvënisi ka parashikuar edhe marrëdhënien e këtij gjykimi me procedimin penal. Konkretisht në nenin 5 të Ligjit 10192/2009 është parashikuar;

Marrëdhënia me procedimin penal

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.

3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i

nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Për pasoje, duke qene se jemi para rastit kur për kete vlerë monetare të sekuestruar sipas këtij ligji, ajo i është nënshtruar, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata duhet të urdhëroj pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji dhe jo të mos vendosë fare masa të tilla. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Ky fakt lidhet edhe me konceptin e barrës së provës i cili tek Kodi Penal dhe Procedurës Penale i takon prokurorit ndërsa tek ky gjykim barra e provës i takon personit nën hetim pasuror. Pra, një pasuri e cila nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se është product i veprës/veprimtarisë kriminale ose mjet i kryerjes se vepres penale nuk mund ti nënshtrohet konfiskimit sipas nenit 36 te KP por ne hetimin pasuror mjafton qe subjekti i hetimit te mos arrije te provoj ligjshmerin e prejardhjes se saj dhe ajo konfiskohet.

Për vlerën monetare prej 269 065(*dyqindë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjet e pesë*) lekë vendosur sekuestrimi me vendimin nr.17, datë 09.08.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duhet vendosur revokimi i masës së sekuestrimit dhe kthimin e saj shtetasit SH.M pasi është vlerë monetare e përfutur nga të ardhurat të ligjshme(Paga, etj.). Për pasojë vendimi duhet te percillet tek Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave, Tiranë, sipas neneve 24/a, 13 te Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 7 pika 1 dhe 4, nenit 13, 21, 22, 24, 25, 27/2, 28 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* si dhe nenit 379, 415 të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I:

I.

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë.
1. Konfiskimin e shumave monetare ; vlerën **144 810**(*njëqindë e dyzet e katër mijë e tetëqindë e dhjetë*) **euro**, vlerën **1000**(*një mijë*) **USD** si dhe vlerën **9 335 935**(*nëntë milion e treqindë e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqindë e tridhjetë e pesë*)-**lekë**(*lëne në ruajtje të depozitura në bankën Intesa San Paolo*).
1. Konfiskimin e vlerës monetare në shumën **30 000**(*tridhjetë mijë*) **euro**.
1. Urdhërohet pezullimi i pasojave të ekzekutimit të zbatimit të masës së sekuestrimit dhe konfiskimit për vlerën monetare në shumën **30 000**(*tridhjetë mijë*) **euro**. Pezullimi përfundon menjëherë sapo të bien masat e sekuestrimit apo konfiskimit të vendosura

në kuadër të procedimit penal që lidhet me vendimin penal nr.129, datë 27.11.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

1. Revokimin e masës së sekuestrimit për vlerën monetare prej 269 065(*dyqindë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e pesë*) lekë vendosur me vendimin nr.17, datë 09.08.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke e periashtuar këtë vlerë monetare nga konfiskimi dhe kthimin e saj shtetasit SH.M.
- I. Ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë, për ekzekutimin e këtij vendimi, konkretisht administratori Erjon Ricku.
- I. Shpenzimet procedurale në masën e bërë në ngarkim të të paditurit SH.M.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda pesëmbëdhjetë ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, në datë 15.07.2020.

SEKRETARE
Olivia MYFTIU

GJYQTAR
Fran PRENDI

